

**INSTITUCIONI I GJAKMARRJES SIPAS KANUNIT TË LEKË
DUKAGJINIT DHE ÇËSHTJE E ÇRRËNJOSJES SË GJAKMARRJES**

**THE INSTITUTION OF BLOOD FEUD ACCORDING TO LEKË
DUKAGJINI CODE AND THE ISSUE OF ERADICATING BLOOD
FEUD**

Mirushe HOXHA¹

¹ *Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology "Blazhe Koneski", University "Ss. Cyril and Methodius" -
Skopje*

^{*} *Corresponding author e-mail: hmirushe@yahoo.com*

Abstract

The Lekë Dukagjini Code (LDC) is the most systematized form of Albanian customary law. The twelve chapters ("Books") of the Code with a total of 1263 paragraphs express the social organization by the tribe, in the absence of the state as a territorial unit with an institutional governmental organization. The institution of blood feud takes shape through the definition of this phenomenon and the regulation of its conditions and procedures, mainly in the tenth chapter entitled "Libri Kundra Mbrapshitëvet" (Book against bad deeds). This article intends to illuminate the fact that the institution of blood feud according to the LDC prohibits murder and aims the eradication of blood feud, in order to give an adequate direction towards the eradication of the deformed blood feud in the presence of the state and the Criminal Code.

Keywords: customary law, Lekë Dukagjini Code, murder, blood feud, *besa*, self-judgment, eradication of blood feud.

Përmbledhje

Kanuni i Lekë Dukagjinit (KLD; Kanun/i) është forma më e sistemuar e të drejtës zakonore shqiptare. Dymbëdhjetë kapitujt („Librat”) e KLD-së me gjithsej 1263 paragrafë shprehin organizimin shoqëror nga ana e fisit, në mungesë të shtetit si njësi territoriale me organizim qeveritar institucional. Institucioni i gjakmarrjes merr trajtë përmes definimit të kësaj dukurie dhe rregullimit të kushteve dhe procedurave të saj, kryesisht në kapitullin e dhjetë të titulluar „Libri Kundra Mbrapshitëvet” (Libri kundër veprave të këqija). Ky artikull ka për qëllim të arguemntojë se institucioni i gjakmarrjes sipas KLD-së e ndalon vrasjen dhe synon çrrënjosjen e gjakmarrjes, për të dhënë një kahje adekuate drejt çrrënjosjes së gjakmarrjes të tjetërsuar në prezencë të Kodit penal të shtetit.

Fjalët kyçe: e drejta zakonore, Kanuni i Lekë Dukagjinit, vrasja, gjakmarrja, *besa*, vetëgjyqësia, çrrënjosja e gjakmarrjes.

1. Hyrje

E drejta zakonore ka të bëjë me tërësinë e rregullave dhe të praktikave të një mënyre të caktuar të jetesës, e që në sytë e bartësve të mënyrës së jetesës ka cilësi detyruese. Në zanafillë, kjo tërësi është krijimtari e përbashkët e popullit apo e komunitetit që e zbaton, dhe ajo përcillet nga brezi në brez si një traditë gojore. Cilësia detyruese e normave dhe e praktikave, në krye të herës populli si ligjdhënës, dhe përcjellja e tërësisë së normave nga një brez te tjetri në formë të pashkruar janë tri paret kryesore në bazë të të cilave mund të flasim për të drejtë zakonore.

Si e tillë, “e drejta zakonore” dallon nga “e drejta zakonore ndërkombëtare” që u referohet obligimeve ndërkombëtare lidhur me praktikën e përgjithshme të pranuar si ligje. Fjala shqipe për të drejtën zakonore të shqiptarëve është *kanun*. Kanuni i Lekë Dukagjinit (KLD, Kanun/i) është forma më e sistemuar e të drejtës zakonore të shqiptarëve, rrjedhimisht, Kanuni më i referuar shqiptar. Emri tjetër i KLD-së është Kanuni i Maleve. At Shtjefën Gjeçovi (1873-1929) e mblodhi Kanunin në terren, e kodifikoi, dhe nisi të botojë pjesë të tij me emrin *Kanuni i Lekë Dukagjinit*. Me po të njëjtin emër u botua forma përfundimtare e materialit të kodifikuar, pas vdekjes së Gjeçovit.

Tërësia e institucioneve në dymbëdhjetë kapitujt („Librat“) e KLD-së²⁹⁶ pasqyron organizimin shoqëror nga ana e fisit në kushte të mungesës së **shtetit shqiptar si njësi territoriale me një organizim qeveritar insitucional**. Fakti që esenca e gjakmarrjes rregullohet brenda „Kapitullit kundër veprave të këqija“ është provë në vete që dëshmon se sipas KLD-së, gjakmarrja është *vepër e keqe* dhe se KLD-ja rregullon çështje *kundër* gjakmarrjes. Çështja e çrrënjësjes së gjakmarrjes është thelbi i institucionit të gjakmarrjes sipas Kanunit. Zinxiret e gjakmarrjeve që zgjasin vite apo decenie me radhë nuk janë sipas Kanunit.

Ato rrëfehen edhe para shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë në vitin 1912, gjë që na lë të kuptojmë se fillimet e devijimit të gjakmarrjes nga Kanuni nuk duhet kërkuar vetëm në kohët moderne. Sidoqoftë, përderisa fillimet e devijimit të gjakmarrjes nga Kanuni kufizohen kryesisht në zinxhret e gjakmarrjeve, në kohët moderne gjakmarrja nuk respekton pothuajse asnjë normë të Kanunit. Aq më shumë, gjakmarrja e tjetërsuar krijon mbivendosje të Kanunit ndaj Kodit penal të shtetit.

2. Definimi i gjakmarrjes, terminologjitë kyçe, parimi i gjakmarrjes, dhe vetëgjyqësia

Fjala “gjak” në Kanun ka kuptimet e ‘relacionit të gjakut me dikë’ dhe të ‘vrasjes me plumb pushke / arme’.²⁹⁷ “Me marr gjak” (**gjakmarrje**) do të thotë **vrasje për relacion gjaku me të vrrarin**. Togfjalëshat “të ramit në gjak” / “bjen në gjak”, “i kam gjakun (gjak)”, (situatë që të) “lshon në gjak” nënkuptojnë mbi të gjitha konstatim të vrasjes së parë (“pushka e parë”), që si pasojë sjell, por jo medoemos, “ndjekjen për gjak”.²⁹⁸ “Me ndjek për gjak” / “e ndjekme me pushkë” nënkupton intervalin kohor drejt gjakmarrjes si vrasje të dytë (“pushka e dytë”).

²⁹⁶ Forma përfundimtare e KLD-së e botuar në vitin 1933 përmban 12 kapituj apo pjesë („libra“), 24 „krerë“, 199 nene („nyje“) dhe 1263 paragrafë që mbulojnë kodin e sjelljes individuale dhe kolektive. Kjo përmbledhje ka shtojcën me shembuj të zbatimit të KLD-së. Dymbëdhjetë librat (kapitujt; pjesët) e KLD-së janë: „Kisha“, „Familja“, „Martesa“, „Shtëpia, gjaja dhe prona“, „Puna“, „Të Dhanuanat“, „Fjala e Gojës“, „Dera (nderi)“, „Damet“, „Libri kundra Mbrapeshitëvet (veprave të këqija)“, „Kanuni i Pleqnisë“, dhe „Shlirime dhe Përrjashtime“.

²⁹⁷ Fjalët ‘gjak’ dhe ‘vrasje’ shpesh përdoren si të shkëmbyeshme. Lexuesi i KLD-së duhet të zërthejë nga konteksti se a bëhet fjalë për ‘vrasje’, apo për ‘relacion gjaku me dikë’ (krahaso nenin 124).

²⁹⁸ Krahaso, p.sh., nenin 132, para. 945.

Togfjalëshi “me la gjak” nuk e ka kuptimin e togfjalëshit “me marr gjak”, por e ka kuptimin e pagesës së gjobës për vrasje të parë²⁹⁹ (e cila ndiqet ose nuk ndiqet për gjak). Nuk ka kuptim të njëjtë as togfjalëshi “me marr gjak” me togfjalëshin “me la dam”, që në literaturë shpeshherë interperetohet si ‘hakmarrje’ (me shpjegimin se KLD-ja bën dallim mes gjakmarrjes dhe hakmarrjes). “Me la dam” ka kuptimin e ‘dëmshtëpërlimit për pronën e vjedhur’: “për çdo dam i lahet dami të damtuemit” (neni 109, para. 74). Për dallim nga gjakmarrja, “dami ka çmim por jo pushkë” (neni 109, para. 739)³⁰⁰. Fjala “pushkë” ka dy kuptime: ‘armë pushke’ dhe ‘plumb’. “Një pushkë” do të thotë ‘një plumb’; në rrethanat në të cilat thuhet “një pushkë”, vrasja me vetëm një plumb nënkupton rregull Kanuni që nuk guxon të thyhet.

Parimi i gjakmarrjes sipas KLD-së është „**gjaku per faj nuk jet**” = vrasja dallon nga faji / vrasja dhe faji nuk janë të njëjta (vrasja është më shumë se faji; vrasja është faj që e tejkalon fajin /= “nuk jet”). Me këtë parim titullohet neni 127, ku paragrafi 909 e ndalon vrasjen: „Çdo faj, qi fi bajë Shqyptari Shqyptarit, tager ka me e mundue me pleq e me pegje, porse **nuk** mund t’a vrasë, se „Gjaku per faj nuk jet“ [theksim i shtuar]. Para se t’i drejtohet armës, shqiptari ka për detyrë të përpiqet ta falë *fajin* që i është bërë. Nëse individi nuk e fal *fajin* e, për shembull, kërcënimit, dhe e vret bartësin e *fajit*, atëherë ai do të ndëshkohet me gjobë, ndërkohë që “shtëpia” e viktimës (e të vrarit) do të ketë të drejtë të zgjedhë mes dy zgjidhjeve të problemit: ose të “falë fisnikërisht”, ose ta vrasë vrasësin (autorin e vrasjes) / “dorërasin” (= gjakmarrje). (“Kanuja thotë: në daç, fale, po deshte, laje ballin e vrugulluem” /para. 595/). Zgjedhja e dytë, që ka për bazë parimin e gjakmarrjes, definohet me nenin 131 para. 940: “Gjaku shkon per gjak”, dhe me nenin 128 („Gjaku s’bahet gjobë“ /Vrasja nuk zëvendësohet me gjobë/) para. 916: „Gjaku gjak, gioba gjobë, thotë Kanuja“.³⁰¹ Shfuqizimi i parimit të gjakmarrjes „gjaku per faj nuk jet“ vlen vetëm për një rrethanë të vrasjes (neni 132, para. 921; 953; krahaso paragrafin e parafundit të nëntiullit /3/).

Kanuni ka institucionet e gjyqit të pleqësisë (të cilin e përfaqësojnë “gjindja e urtë”), të porotës, dhe të kuvendit, mirëpo këto institucione nuk kanë kompetencë të gjykojnë dhe të vendosin se a do të zbatohet parimi i gjakmarrjes, as kanë kompetencë ekzekutimi për gjakmarrje.³⁰² Familja e viktimës është ajo e cila duke u thirrur në Kanunin do të gjykojë se a do të vendosë për “pajtim gjaku” (nëse hamendet, poqese bindet nga këshillat e njerëzve të urtë dhe të dashamirëve), ose do të gjakmerret sipas rregullave të Kanunit. Prandaj dhe themi se gjakmarrja sipas Kanunit gjen zbatim përmes vetëgjyqësisë. Kanuni nuk ka nen apo nene me të cilat e deklaronte vetëgjyqësinë, mirëpo vetëgjyqësia brenda institucionit të gjakmarrjes është e nënkuptuar.

Kanuni nuk ka nen apo nene në të cilat nënkuptohet lejimi i zinxirit të gjakmarrjeve, as nen apo nene që parashikojnë apo deklarojnë vrasje të tretë, të katërt, e kështu me radhë (tëresia e të cilave do të kishte nënkuptuar zinxir gjakmarrjesh). Paragrafi i cili mund të interpretohet gabimisht si lejues i zinxhireve të gjakmarrjeve është paragrafi 917 dhe në të fjala “kurrë”: „Gjaku s’hupë kurrë“. Fjala „kurrë“ në paragrafin 917 „Gjaku s’hupë kurrë“ duhet të interpretohet në kontekst.

²⁹⁹ “Pushka e nisun ka gjobë. – “Pushka e pare ka gjobë” (neni 132, para. 941). „Po e shkrepri i pari pushken e nuk i ndezi, i dyti i ndej gati edhe e vrau, ky bjen në gjak, por jo në ndeshkim të gjobës, se „Pushka e mbrame nuk jet me të paren“ (neni 132, para. 944).

³⁰⁰ Vjedhja do të vlerësohet siaps dëmit dhe do të gjobet dyfish. Krahaso edhe nenet 112 dhe 113.

³⁰¹ Neni 132 („Pushka ndjekë gjaksin“) parashikon: “Pushka e shkrepun mbë kedo ka gjobë” (para. 956), dhe „E shkrepnja ka gjobë“ (para. 942). Në këtë vijë, “Per çdo vrasë: 6 qese per gjak, 100 desh e 1 ka gjobë Flamurit e 500 grosh derës së Giomarkut t’Oroshit (per Mirditë) (para. 957). Ose, neni 124 („Gjaku“) paragrafi 892 thotë: “Kush të vras nierin pra, kje burre a grue, djalë a cucë a edhe ferishte djepi, i mirë a sherntim per dukë, krye, plak a sterplak, i pasë a i pa-pasë, fisnik a firuk, ndeshkimi asht një doret: per vrasë të mashkullit 6 qese, 100 desh e gjysë kau gjobë”.

³⁰² Gjyqi i pleqësisë do të vendosë për gjobën, gjithashtu do të përpiqet ta bindë familjen e viktimës që t’i shmangët gjakmarrjes, mirëpo nuk do të gjykojë se a duhet apo nuk duhet të zbatohet gjakmarrja.

Konteksti është paragrafi që i paraprin (916) „Gjaku gjak, gioba giobë“, dhe paragrafi 918 në vazhdim, ku thuhet se vrasja e parë duhet të paguhet me gjobë, mirëpo pagesa e gjobës, në parim, nuk është dëmshpërblim për humbjen e një jete. Zinxhiri i gjakmarrjeve nuk është sipas Kanunit.

3. Institucioni i gjakmarrjes sipas KLD-së: Ndalimet e ndjekjes për gjak

Para së gjithash, ndalohet ndjekja për gjak e grave, e fëmijëve (pa dallim gjinie), dhe e priftërinjve.³⁰³ Sipas nenit 118 (“Prita”) para. 835, „Prita do të fillojë pushken mbë burra e jo mbë gra, fini, mbë shpi e mbë baleti“. Sipas nenit 124 (“Gjaku”) para. 897, „Me grani të dorërasit sla punë shpija e të vramit, sepse “Grueja e Prifti nuk bien në gjak“. Apo, „Kanuni i Malevet të Shqypnis shliron e perjashton (...) Priftin, i cilli (...) s’ndjekë kend per gjak të prindës“ (Libri i dymbëdhjetë “Shlirime e perjashtime”, para. 1221 dhe para. 1222d). Për sa u përket grave, përjashtim bëjnë *virgjëreshat e betuara*. Në kapitullin „Përjashtime e shlirime“ nuk thuhet se „virgjinat“ nuk ndiqen për gjak, dhe kjo është në përputhje me konceptin e *virgjëreshave të betuara*. Për sa u përket fëmijeve pa dallim gjinie, mashkulli është fëmijë deri në moshën 15 vjeçare; pas kësaj moshe, djali konsiderohet burrë (p.sh., para. 116).

Ndalohet ndjekja për gjak për tentativë të vrasjes. Në këto rrethana, ndëshkimi është me gjobë dhe gjobën duhet ta paguajë burri i cili i pari e shkrep pushkën. Tentativa e vrasjes nënkupton rrethanën në të cilën dy burra hyjnë në konflikt, njëri prej tyre shkrep me pushkë por tjetrin nuk e vret, ose pushka nuk i shkrep dot. Këto kushte janë paraparë në nenin 132 („Pushka ndjekë gjakësin“). Para. 941: „Pushka e nisun ka giobë“. – „Pushka e pare ka giobë“, dhe para. 942: „E shkrepnja ka giobë“. Ndalohet ndjekja për gjak (mes „shtëpive“) kur dy burra vriten gjatë përleshjes (asnjëri prej tyre nuk mbetet gjallë). Këtë rrethanë e rregullon neni 126 („Gjaku per gjak me mbetë“). Sipas para. 901, “Kur të vrase shoqi shoqin dy vetët, qi u fjalisen, e biejn të dy dekun, jesin krye i per krey, ase gjak per gjak”. Sipas paragrafit 902, „Shpijat e të vramvet nuk mund të shtyhen në fjalë, as nuk mund të lypin shperblime lagjja lagies. – Do të dorzaniten mbas kanunit”.

Ndalohet ndjekja për gjak për vrasje nga pakujdesia (“pa hiri”) : “Vrasa pa hiri nuk e ka të ndjekmen me pushkë. – Dorëra lan giakun e dorzanitet” (neni 130, par. 932). “Me shkrepë pushka pa hiri, i zoti i pushkës bien në gjak, po vrau a shitoi kend” (neni 132, para. 945). “Pushka, qe vret pa hiri, ka giakun gjak, por s’ka giobë as të ndjekmen” (neni 132, para. 955), ose “vrasa pa hiri nuk ka giobë” (neni 130, para. 938). “Me vra kush – edhe pa hiri – gruen me shtat xanë, posë 3 qesevet të gjakut të grues, i a presin edhe barres 3 qese” (neni 130, para. 935). Vrasja e pavullnetshme duhet të vërtetohet nga “gjindja e urtë” (neni 130, para. 934). Derisa të vërtetohet, vrasësi duhet „të fshihet“ (ngujohet) (neni 130, para. 933). Vrasësi “dorzanitet” dhe e “lan çmimin e gjakut” pasi që të “vërtetohet se pernjimend kie pa hiri vrasa” (neni 130, para. 934).

„Gjaku” mundet edhe „të humbet”. “Gjaku humbet”, ndalohet “ndjekja për gjak”, dhe me këtë përfundon çështja në këto tri rrethana: (1) nëse vëllai vret vëllanë (vrasësi dënohet vetëm me gjobë): „Po e vrau i vllai të vilan, gjakhupës shkon, porse gioben e Flamurit do t’a bajn si mbas kanunit” (neni 133, para. 960); (2) nëse dikush vetëvritet: „Po e vrau kush vedin, gjaku shkon hupës“ (neni 133, para. 958; neni 33 para.59(b)), dhe (3) nëse një burrë dhe nje grua vriten për motiv tradhtie në flagrancë: “i marruemi e e marruenja (...) shkoin giak-hupës, kur të

³⁰³ Përjashtimi i priftit nga gjakmarrja sipas Kanunit, vlen prej periudhës mesjetare. Mesjeta si periudhë e zanafilës së Kanunit është në kundërtënie me gjenezën e popullit shqiptar, e cila njihet “tri nyje” që janë “parailirët, ilirët dhe arbërit” (krahaso Korkuti, 2003, f. 2). Në anën tjetër, përjashtimi i grave dhe i fëmijëve që në zanafilë të Kanunit është në përputhje me implikimet e “zakonit të kuvadës” në Malësi të Madhe, që është mbetje e drejtpërdrejtë e matriarkatit në etnografinë shqiptare (krahaso Çabej me literaturë, 1977 III, f. 42), dhe në përputhje me treguesit e tërthortë të mbetjeve të matriarkatit në KLD-në (krahaso Hoxha, 2017).

vriten në punë e në mndyrë të keqe **me një pushkë** [theksim i shtuar]” (neni 129 „Gjaku per pune të ligë“, para. 923; krahaso edhe para. 920, para. 924-928).

Në kontekstin familjar, përjashtime të “humbjes së gjakut” dhe lejime të “ndjekjes për gjak” vlejné për tri rrethana: (1) nëse djali veret të ëmën – me ç’rast djali bjen në gjak me familjen e nënës së tij (neni 133, para. 962; neni 34 para. 61(c)), (2) nëse bashkëshorti e vret bashkëshorten për motive që nuk kanë të bëjnë me tradhti në flagrancë – me ç’rast bashkëshorti bjen në gjak me prindërit e bashkëshortes (neni 133, para. 963), dhe (3) nëse bashkëshortja e vret bashkëshortin për çfarëdo qoftë motivi – me ç’rast prindëriet e saj bijné në gjak me familjen e bashkëshortit të vrarë (neni 133 para. 964).

“Gjaku humbet”, ndalohet “ndjekja për gjak”, mirëpo vrasësi ekzekutohet nga katundi – “grihet katundisht” – në dy rrethana, në njërën prej të cilave vrasësi (mund të) “grihet” (ekzekutohet) edhe “prej fisit”: (1) nëse djali vret të atin: „Po vrau i biri t’an, s’e ndjek kush, porse i biri, dorëras, grihet a prej fisit a edhe katundisht” (neni 133, para. 961; krahaso edhe nenin 119 /“Dorëras”/, para. 848); “me vra i biri t’anë, fisi **a grin** dorërsin **ase** e xjerrë vendit për gjithherë [theksim i shtuar]” (neni 35, para. 62(j)), dhe (2) *vraska e “të pabesit”*: ”I pabesi, qi pret kend vetë a shet kend në besë, grihet katundisht e shkon gjakupës” (neni 97 /“Të premt e mikut”/, para. 648). Vrasësi “grihet katundisht”, mirëpo nuk përcaktohet se a “humbet gjaku” në shtatë rrethana të përcaktuara me nenin 157 para. 1194(a) – 1194(g), nenin 157 para. 1195, nenin 57 para. 251, dhe nenin 158 para. 1212. Alternativën e “të grimes katundisht” e parashikon neni 141 para. 1006.

Nuk kategorizohet si “humbje gjaku” rrethana në të cilën ndalohet ndjekja për gjak e vrasësit që ka vrarë burrë i cili ka përdhunuar vajzë apo grua. Vrasësi i cili për motiv të vrasjes ka përdhunimin (përdhunuesin) e vajzës dhe të gruas nuk ndiqet për gjak dhe nuk ndëshkohet me gjobë: “Pushka e shtime per grue a cucë të dhunueme s’ka as gjak as gjobë” (neni 132, para. 953). Kjo është rrethana e vetme e cila e parashikon **shfuqizimin** e parimit “gjaku per faj nuk jet”: “Parimi “Gjaku per faj s’jet”, në dhunim të gravet e bjerrë fuqin e vet” (neni 129, para. 921). Themë rrethana e vetme, e papërligjshme, pikërisht për shkak të humbjes së fuqisë të parimit të gjakmarrjes (krahaso edhe nenin 28). Sipas paragrafit 922, „Mikun e prem, armët e gruen e dhunueme, kanuja s’i perket“³⁰⁴, mirëpo paragrafi 921 është i qartë se, megjithatë, parimi i gjakmarrjes „gjaku per faj nuk jet” nuk është i paprecedent edhe për rrethanat e mikut të prerë në besë dhe të armëve të marra me dhunë.

Të gjitha rrethanat e lejitimit të ndjekjes për gjak, përveç rrethanës të papërligjshme të parashikuar me nenin 129 para. 921 dhe të plotësuar me nenin 28, kanë alternativën e faljes së gjakut. Atëherë, Kanuni parashikon rrethana të ndalimit të gjakmarrjes dhe rrethana të lejitimit të gjakmarrjes me alternativë të faljes së gjakut. Kjo dëshmon se vetëgjyqësia e Kanunit në asnjë rrethanë nuk e inkurajon gjakmarrjen, ndërkohë që pa alternativë të *faljes* dhe të *gjakmarrjes* e lejon vetëm vrasjen e burrit që ka përdhunuar vajzë ose grua.

³⁰⁴ Miku i prerë në besë është mysafiri i cili vritet në shtëpinë e nikoqirit (që mund të ndodhë më rrallë) ose 24 orë pasi që të ketë dalë nga shtëpia e nikoqirit (që mund të ndodhë më shpesh), e ku do ta ketë ngrënë bukën e nikoqirit. 24 orët lidhen me konceptin e *besës*. Në kontekstin e “mikut të prem në besë”, 24 orët nënkuptojnë kohëzgjatjen e digjestimit të bukës (së nikoqirit) që konsiderohet si kohë brenda se cilës miku është në mbrojtjen e nikoqirit. Lidhur me vrasjen e dhunuesit të mikut në besë, krahaso nenin 132 (“Pushka e ndjekë gjaksin”) para. 952: “Pushka e shtime per mik të prem të lshon në gjak, por jo në gjobë. Lidhur me vrasjen e dhunuesit të armëve, krahaso nenin 132 para. 954: ”Pushka e shtime per armë të marruna, bien në gjak, por jo në gjobë”.

4. Institucioni i besës brenda institucionit të gjakmarrjes: Vuajtësi i gjakmarrjes dhe 24 orët e Kanunit

Sipas Kanunit, „Besa asht një vade lirije e sigurimi, qi shpija e të vramit i ep dorërasit e shpijarvet të tij, tuj mos i ndjekë per gjak **perkohesisht e mje në vade të caktueme** [theksim i shtuar]“ (Besa është një periudhë e lirisë dhe e sigurisë të cilën vrasësit dhe familjes së tij ia jep familja e viktimës, duke e pezulluar përkohësisht marrjen e gjakut deri në përfundim të periudhës së caktuar) (neni 122, para. 854). „Dorërasit“ (vrasësi; „gjaksi“; „gjaksori“) – „aj, i cili vret kend me dorë t’vet“ (neni 119, para. 843) – duhet t’i tregojë „shtëpisë“ së njeriut që e ka vrarë për vrasjen që e ka kryer (neni 119, para. 844) dhe përmes „bestarëve“ (neni 121, para. 851) **duhet** të kërkojë besë nga „shtëpia“ e njeriut që e ka vrarë (viktimës) (neni 119, para. 845), kurse „shtëpia“ e viktimës **duhet** t’i japë vrasësit besë 24 orëshe (neni 122, para. 856).

Themi **duhet**, sepse “me çue gjind për besë asht **kanu**, me dhanë besë asht **detyrë** e burni [theksim i shtuar]” (neni 122, para. 855). Aq më shumë, vrasësi nuk guxon ta marrë armën e të vramit; në të kundërtën, ai „bjen në dy gjaqe“ (neni 119, para. 847). Pastaj, trupin e të vramit duhet ta kthejë mbarë, nuk guxon ta masakrojë (gjymtojë), dhe armën e të vramit duhet ta mbështesë pranë kokës të të vramit (neni 119, para. 846). Me pëlqimin e askujt tjetër përveç shtëpisë së viktimës, fshati duhet t’i japë vrasësit besë 30 ditëshe (neni 122, para. 861; para. 859). Sidoqoftë, menjëherë pasi që të varrosët viktimën, fshati ka të drejtë ta tërheqë besën 30 ditëshe që ia ka dhënë vrasësit (neni 122, para. 858). Nëse dhe përderisa shtëpia e viktimës hamendet për besë fshati (30 ditëshe), që nënkupton kohëzgjatje të pacaktuar, vrasësi me gjithë familjen e tij brenda gjithë asaj kohe duhet të ngujohet (neni 122, para. 860).

Kanuni lejon që shtëpia e viktimës t’u japë besë edhe „miqëve dhe dashamirëve“, mirëpo vetëm pasi që të japë besë fshati (neni 122, para. 844). Me të dhënë besë fshati (të cilën fshati ka të drejtë ta tërheqë pas varrosjes së viktimës), dhe me të hapur rrugën e besës dhënë miqëve e dashamirëve, këta të fundit kanë të drejtë të kërkojnë „besë fisi“ : “Po e çili besen e fisit shpija e të vramit, gjith sa fiseve të jenë në katund të tij do t’u apë besë as ma pak e as ma teper” (neni 122, para. 863). Kohëzgjatja e kësaj besë nuk përcaktohet. *Besa* mundet “të këputet“, nëse shtëpia e vrasësit përderisa zgjat *besa* nuk sillet kujdesshëm ndaj shtëpisë së viktimës (neni 122, para. 866 – 867). Sidoqoftë, „këputja e besës“ nuk do të ndodhë para qortimit, e nëse nuk ka efekt qortimi, para ndëshkimit me gjobë (para. 867).

Kanuni e ritualizon *besën* 24 orëshe, të cilën shtëpia e viktimës ia jep vrasësit. Ritualizimi parashikon vrasje të ndërgjegjjes së vrasësit para vrasjes së tij fizike. Sipas Kanunit, „Shpija e të vramit, po i dha besë dorërasit, ky edhepse e vrau, do të shkojë në mort e në gjamë me percjellë të vramin deri në vorrim e me ndejë për drekë. Kio besë ngjatë 24 orë“ (neni 122, para. 856). Të gjithë do të heshtin, *besa* është dhënë. Vrasësi do të shkojë në varrimin dhe gjamën e njeriut që e ka vrarë, vrasësi do ta hajë bukën e shtëpisë së njeriut që e ka vrarë, vrasësi të gjithë do t’i shikojë në sy – ndërkohë që të gjithë sytë përreth tij do ta dinë se vrasësi është ai. Kjo e fundit përbën dallimin mes vrasësit sipas Kanunit dhe vrasësit të sotëm. Aq më shumë, nëse vrasësi pas *besës* që i është dhënë nuk shkon në ceremoninë e varrimit të njeriut që e ka vrarë, kjo nuk do të konsiderohet si “shburrnim” për shtëpinë e të vramit; përkundrazi, mosprezenca e vrasësit do ta “shtojë dhunën mbi dhunë” (neni 122, para. 857).³⁰⁵

³⁰⁵ Nga perspektiva e riteve të kalimit (*rites de passage*, krahaso Gennep, 1960), ritualizimi i vrasjes së ndërgjegjjes së vrasësit para vrasjes së tij fizike (KLD, neni 122, para. 856) përmban elemente të fazës *liminale*, ose të kalimit nga një status në statusin tjetër. Në rastin konkret, ballafaqim të individit me kalimin nga statusi i jo-vrasësit në statusin e vrasësit. Sipas Turner (1974; 1077), atributet e liminales ose të personës liminale (threshold people) janë “domosdoshmërisht ambivalente”. Ajo që KLD-ja me para. 856 na e ofron si “domosdoshmërisht ambivalente” janë ndjenjat e individit të ballafaqim me këtë pragraf (rregull të Kanunit). Neni 122 para. 856 bën ritualizimin e ballafaqimit të individit me ndjenjën e hidhërimit në rast se vendos të kalojë në statusin e vrasësit, dhe me ndjenjën e jetësimit nëse vendos të falë dhe mos vrasë / mos gjakmerret. Me këtë përmbajtje, KLD-ja me para. 856 jep një shembull të asaj që do të doja ta quaj “ndjenjat ambivalente si ritualizim i *liminales*”.

Atëherë, edhe zinxhiri i gjakmarrjes në kohën e Kanunit, megjithëse devijim nga Kanuni, ndryshon diametralisht nga zinxhiri i gjakmarrjes pas kohës së Kanunit.

5. Përfundim

Kanuni i Lekë Dukagjinit (KLD) u krijua ndër shekuj duke shtresuar mbetje mbi mbetje, për të marrë një formë përfundimtare me botimin e tij në vitin 1933. Institucioni i gjakmarrjes sipas KLD-së ka për qëllim çrrënjosjen e gjakmarrjes, vrasjes për relacion gjaku me të vararin. KLD-ja e ndalon vrasjen (neni 127, para. 909), dhe parimi i gjakmarrjes është „gjaku për faj nuk jet“ (ibid.) = vrasja („gjaku“) dallon nga faji (çdo krim tjetër, apo fyerje publike). Parimi i gjakmarrjes gjen zbatim në njërin nga dy zgjedhjet e zgjidhjes së problemit që Kanuni ia ofron familjes së viktimës, dhe ajo është zgjedhja e *gjakmarrjes kundruell* zgjedhjes së *të falurit fisnikërisht*. Gjopa është ura lidhëse mes dy zgjedhjeve (neni 128, para. 916).

Rrethana e vetme që e shfuqizon parimin e gjakmarrjes vlen për burrin që vret burrë i cili ka përdhunuar vajzë ose grua (neni 132, para. 921). Ritualizimi i vrasjes së ndërjegjjes së vrasësit sipas institucionit të besës brenda institucionit të gjakmarrjes (neni 122, para. 856-857) është strategjia më efektive e KLD-së drejt çrrënjosjes së gjakmarrjes. Problemi i çrrënjosjes së gjakmarrjes përmes vetëgjyqësisë është çështje komplekse. Rrënjët e kësaj çështjeje duhet gjurmuar në atë që do të preferoja ta quaj *pothuajse dogma e Kanunit të Maleve me elemente pagane*, dhe të cilën lexuesit do t'ia prezantoj me ndonjë rast tjetër. Si e tillë, ajo mbetet e shtresuar në të pavetëdijshmen kulturore të shqiptarëve, e cila, njësoj si edhe e pavetëdijshmja personale dhe ajo kolektive, nuk mundet të asgjësohet – ndërkohë që e vetëdijshmja e individit mund ta pranojë ose ta refuzojë Kanunin.³⁰⁶ Prandaj Kanuni dhe ka mbijetuar shtete dhe religjione.

Vlerësimi i Fishtës (1933) për gjakmarrjen mbetet i pakontestueshëm: „marrja e gjakut ka qenë një veprim i drejtë, i ligjshëm, dhe i domosdoshëm për gjithë periudhën që Shqipëria ka qenë pa shtet“ (f. 27). Mirëpo Kanuni dhe vetëgjyqësia e **përrjashtojnë shtetin**. Kjo nuk do të thotë se në prezencë të shtetit, Kanuni duhet censuruar apo djegur. Përkundrazi; shteti mundet ta **përrjashtojë vetëgjyqësinë** duke e zhvendosur Kanunin në suaza të një trashëgimie kulturore dhe shpirtërore, nëse arrin të gjejë **zgjidhje adekuate për të pavetëdijshmen kulturore** të shqiptarëve **brenda Kodit penal të shtetit**.

Referencat

- [1]. Çabej, Eqrem. 1977. *Studime gjuhësore III*. Prishtinë: Rilindja.
- [2]. Fishta, Gjergj. 1933/1993. Parathënie. Sh. Gjeçovi, *Kanuni i Lekë Dukagjinit*. Tiranë: Albinform.
- [3]. Gennep, Arnold van. 1960. *The rites of Passage*. Chicago: The University of Chicago Press.
- [4]. Gjeçovi, Shtjefën. 1933/1993. *Kanuni i Lekë Dukagjinit*. Tiranë: Albinform.
- [5]. Henderson, Joe. 1962. “The Archetype of Culture”. A. Guggenbuhl-Craig, ed. *Proceedings of the Second International Congress for Analytical Psychology*. Basel/New York, S. Karger, 1964 (f. 3-14).
- [6]. Hoxha, Mirushe. 2017. “*Заколнетите девици и Канунот на Лек Дукагини: кон супстратите на матријархатот во споделените балкански културни шеми и мотиви*”. f. 115-126. *Македонска Академија на Науките и Уметностите. Одделение за лингвистика и литературна наука. Прилози XLII 1-2*. Скопје 2017.
- [7]. Jung, Carl Gustav. 1936. ‘The concept of the collective unconscious’. *Collective Works 9*. Princeton: Princeton University Press.

³⁰⁶ “E pavetëdijshmja kulturore” (Henderson, 1962) është shtresa ndërmjetëse ndërmjet të pavetëdijshmes personale dhe të pavetëdijshmes kolektive (të pandërgjegjshmes personale dhe asaj kolektive) sipas C. G. Jung (1936, para. 90). Sipas Henderson (ibid., f. 8-9), “e pavetëdijshmja kulturore është e ndërtuar mbi ndikime të caktuara nga jeta familjare (...) një pjesë e rëndësishme e këtyre kanuneve është përcjellë nga brezat e mëparshëm. Rrjedhimisht, pjesa më e madhe e asaj që është quajtur e pavetëdijshme personale nuk është aspak personale, por është pjesë e modelit të kulturës kolektive të transmetuar përmes mjedisit tonë para se të ishim në gjendje të afirmim vlefshmërinë e saj për vetëdijen e egos”.

- [8]. Korkuti, Muzafer. 2003. *Parailirët, Ilirët, Arbërit: histori e shkurtër*. Tiranë: Toena.
- [9]. Turner, Victor. 1974. „Liminal to Liminoid in Play, Flow, and Ritual: An Essay in Comparative Symbology”. *Rice Institute Pamphlet – Rice Institute Studies*. 60 (3). Rice University.